



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6, datë 29.05.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo | 23.Bujar Osmënaj |
| 2.Vullnet Bilbilaj | 24.Atird Hoxha |
| 3.Ardian Musta | 25.Elpinqi Mërkuri |
| 4.Roland Strakosha | 26.Lorel Canaj |
| 5.Evis Allushi | 27.Ledja Shollaj |
| 6.Sokol Kushta | 28.Brikena Sika |
| 7.Gëzim Çapoj | 29.Arsen Belaj |
| 8.Klodian Xhyheri | 30.Dikens Bushaj |
| 9.Illir Aliaj | 31.Vjola Xhafaj |
| 10.Mujo Shakaj | 32.Anisa Ceno |
| 11.Myzafer Elezi | 33.Shkëlqim Leskaj |
| 12.Ervis Moçka | 34.Eglantina Aliaj |
| 13.Eneida Vera | 35.Englantina Imeraj |
| 14.Novrus Rrokaj | 36.Eda Begaj |
| 15.Endri Hyseni | 37.Marsela Dashi |
| 16.Jerina Dervishaj | 38.Briseida Çakërri |
| 17.Gjergji Nika | 39.Rajmonda Zoto |
| 18.Frosina Qyrdeti | 40.Erëmal Arapi |
| 19.Liljana Breshani | 41.Grigor Dede |
| 20.Simbol Pazaj | 42.Edlira Kapllanaj |
| 21.Edison Kapaj | 43.Alta Haluci |
| 22.Besmir Brahimi | 44.Elca Bezhani |

Mungojnë :

- 1.Brikena Puka
- 2.Aurora Qarri
- 3.Refie Laze
- 4.Anxhela Shenaj
- 5.Arjan Isufi
- 6.Geron Gunbardhi
- 7.Liri Dëma



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/1, datë 29.05.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Lidhur me rendin e ditës, keni diçka ?

Z.Gëzim Çapoj – Në mbledhjen e kaluar kërkoja një informacion në lidhje me sezonin turistik. Shikoj që këtu , s'ka gjë. Ne në pikën “Të ndryshme “, bëjmë kërkesa dhe administrata, nuk kthen përgjigje.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Ja kemi përcjellë administratës, por s'ka përgjigje.

Z.Gëzim Çapoj – Këtu duhet të jenë të gjithë drejtorët, për shqetësimet që ne kemi. Jemi këtu për ta kontrolluar dhe ndihmuar administratën. Vetë ata duhet të sjellin materialin. Përgjigjet duhet ti japë administrata.

Znj.Irena Toshkallari – Këtu janë të pranishëm të gjithë drejtorët. Është ngritur një grup multifunksional

Z.Gjergji Nika – Kemi diskutuar në mbledhjen e Konferencës së ryetarëve, për pikën “Të ndryshme” të vihej në pikën 1 të rendit të ditës dhe mbledhjet të zhvillohen në orën 16:00, pasi keni punë.

Nëqoftëse, duam të diskutojmë gjërat për mirë, le ti diskutojmë. Zoti Çapo , ne jemi dakort, zgjidheni ju. Dje kam depozituar një projektvendim.Të tërhiqen 5 minuta kryetarët e grupeve...

Z.Atird Hoxha – Shqetësimet e zotit Çapo dhe zotit Nika ...Ne nuk do bëjmë debat me administratën . Pra, administrata merr problematikat nga këshilltarët dhe jepet, sillet me shkrim përgjigje. Është vetëm një përgjigje që na ka ardhur me shkrim.Ne të gjithë duhet të kemi një qëndrim dinjitoz. Ngrejme problematikat si këshilltarë, sipas zonave që përfaqësojmë. Pra, administrata sjell përgjigje me shkrim, pastaj diskutojmë.

Znj.Alta Haluci – Nëqoftëse, administrata nuk vë asnjë nga ato pika që ne diskutojmë dhe i lënë për në fund, të gjithë ikin. Le të bëhen mbledhje mbasdite. Ne edhe mund ta kontrollojmë bashkinë që nga zgjedhja e personave, sa femra dhe sa meshkuj ...

Zonja Kryetare!

Komisioni i barazisë gjinore dhe i arsimit, nuk është mbledhur asnjëherë.

Vetëm 1 herë është mbledhur komisioni i arsimit, kurse i barazisë gjinore, asnjëherë.

Është një fond për nxënësit ekselentë, shumë mirë.

Kërkuam interperlancë...Çdo lloj kërkesë e bërë nga ne , ka shkuar në fund, janë përgjigjur për çka duan ata.

Prandaj, them që, ky këshill, mungesa e dukshme e drejtorëve, është jo serioze.

Z.Gjergji Nika – Kërkova 5 minuta pushim për konferencën e kryetarëve.

Znj.Evis Allushi – Lidhur me problematikat e turizmit.

Doja të bëja një propozim shumë konkret . Ne të mblihdemi një herë vetëm për problemet e turizmit,ku përveç drejtorëve të administratës së bashkisë, të marrin pjesë dhe përfaqësues nga Policia e shtetit etj...

I kthehem çështjes që kam diskutuar për pikën “Të ndryshme “, ti kthehemi, pasi ka problematika të ndryshme.

Z.Ervis Moçka – Jam dakort, pra ngrejmë pyetje dhe të marrim përgjigje. Them, nuk e strukturojmë .., shqetësimet që nuk trajtohen nga administrata , keni të drejtë . Të mblihdet kryesia dhe ristrukturohet. Nëqoftëse, do të mblihdemi vetëm për këto problematika, drejtorët dalin dhe sot dhe japin përgjigjet e tyre, pasi është puna e tyre e përditëshme.

Jemi përfaqësues të qytetarëve. Të mblihdet kryesia dhe ristrukturohet, kur do jepet përgjigjja.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nuk është e para herë që bëhen këto diskutime. Të gjitha këto kërkesa i kanë shkuar administratës. Nuk është përgjegjësia as e imja, as e sekretarit. Është përgjegjësi e administratës, për të kthyer përgjigje. Nuk mund të them për paaftësi të tyre, por dhe për shkak të angazhimeve të tyre. Le të mblihdet kryesia, kryetarët e grupeve 5 minuta dhe të diskutojnë.

-Rifillon mbledhja në orën 11.20

Znj.Liljana Breshani – Dua të sensibilizoj gjithë qytetarët , është një nismë , ku së bashku me ju anëtarët e këshillit bashkiak, në lidhje me zgjidhjen e situatës së kafshëve të rrugës, me një kontribut të vogëlBashkë me animalistët janë dhe vullnetarë të huaj. Vlora nuk është vetëm e turistëve, është e jona dhe duhet të sigurojmë një qytet të jetueshëm gjatë gjithë vitit.

Znj. Elpinqi Mërkuri – Faleminderit për punën tuaj. I ftoj të gjithë të ndihmojnë në kauzën tuaj.

Znj.Alta Haluci – Ju vërtet jeni animalistë, fondet janë dhënë për qentë e rrugëve, nuk mund të jepen nga këshilli i bashkisë fonde minimaliste. Tëurvejohen fondet ...Kam lexuar mjaft materiale... Është shumë e rëndë kjo situatë. Vërtet jepen fonde, por duhen parë dhe si shfrytëzohen këto fonde.

Znj.Liljana Breshani – Ftoj në një dëgjese publike anëtarët e këshillit të bashkisë dhe grupet e interesit. Nuk është e lehtë të bëhen strehimoret dhe të mirëmbahen. Kushdo që, mund ti ngjitet kësaj nisme , për ta patur në kontroll..Ti japim zgjidhje sa më humane.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ta hedhim në votim, propozimin për zhvillimine mbledhjes, mbasdite ? Mbledhjet e komisioneve, pikat e rendit të ditës, fillimisht të relatonte administrata dhe më pas kryetarët e komisioneve, me propozimet e komisioneve.

Z.Daut Zëraj – Rregullorja...relatohet, Jepen pikat e rendit të ditës, shprehen kryetarët e komisioneve, pastaj administrata.

Z.Ervis Moçka – Jo relatojnë kryetarët e komisioneve dhe, më pas administrata.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Sipas rregullores, është siç tha z.Daut...por, mendoni administrata e para..

Znj.Elca Bezhani – E konsideroj të drejtë , pra si fillim relatton administrata, pastaj kryetarët e komisioneve, opinionet e tyre.

Z.Endri Hyseni – Të njëjtin mendim kemi ..

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kalojmë në rendin e ditës, pika 1.

Z.Gjergji Nika – Dje kam dorëzuar një projektvendim , “Për krijimin dhe funksionimin e Komisioni të Përkohshëm, për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë , nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Vlorë”.

Ky komision përbëhet prej 7 anëtarësh (4+3); emrat e anëtarëve propozohen...

(Lexon projektvendimin)...bashkëngjitur firmosur nga kryetarët e grupeve PD dhe PDIU, zoti Gjergji Nika dhe nga PR,LZHK dhe PA, firmosur nga zoti Geron Gunbardhi.

Është në nderin tuaj që ta kaloni këtë komision. Bashkia ka 43% të Sh.A-së. Anëtarët e bordit mund të vijnë të referojnë ...por kemi tagrin që të kërkojmë llogari dhe të vijnë të na informojnë, si është ndjekur procedura, a është apeluar etj...

Z.Ervis Moçka – U diskutua dhe pak më parë, por mënyra si vjen ky projektakt, nuk është i rregullt. Nuk jemi njohur. Duhej të paraqitej ditë më parë, grupi ynë sot po njihet me këtë projektakt..S’ka ndonjë gjë me urgjencë ...Është e drejta që ia jep rregullorja dhe ligji, mund të ngremë komision...Por juridikisht, nuk jam dakort, tani u njoha me projektaktin.

43% bashki; 51% AKUMI...Ligji e ka të saktë dhe drejtë ..

Ne jemi të legjitimuar, ti kërkojmë përfaqësuesit tanë, të na sqarojnë për situatën, por jo të legjitimojmë ata, drejtuesit kryesorë. Është sistem me dy nivele. Pra, ka një bord , një këshill mbikqyrës që mbikqyr gjithë punën. Nuk e di sa përfaqësues kemi në bord..Është i paqartë objekti dhe juridikisht i paqartë. Do përcaktohen emrat, pasi thoni 4 për ne dhe 3 opozita...Them për procedurë, nuk është e rregullt, e ligjshme për ta futur në rendin e ditës.

Z.Gjergji Nika – Sipas zotit Moçka, meqenëse 51% me 43 %.....bordi nxjerr...në ligjin e kontabilitetit vlen..Komisioni nxjerr bordin mbikqyrës...Duhet ti thërrasim. Kemi shumë kohë që kërkojmë drejtorët nga administrata dhe asnjë nuk na vjen. Duhet ta kalojmë këtë komision.Ka gjyqe..po marrin shuma parash (lexon vendim gjyqi....)

-Këto janë debituar në Fibank 11 milion lekë/reja.

-Vendim gjykate 12 milion lekë/reja, për ekzekutim...dhe ne diskutojmë për 1,9 milion që Ujësjellësi i ka bashkisë.

-120milion lekë/reja, që kanë fituar gjyqin . I kemi me fakte, të debituar.

Prandaj, duhet ky komision.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket rendit të ditës, u morr koha e nevojshme që të binim dakort. Ne ramë dakort që projektvendimi të vihej në rendin e ditës, në konferencën e kryetarëve. Lekët që thotë zoti Nika, janë lekët e qytetarëve.

E kam marrë fjalën për procedurë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ju nuk jeni kryetar grupi, është zoti Xhyheri.

Z.Atird Hoxha – S’fola si kryetar grupi. Ti do na përcaktosh kryetarin e grupit..

Znj.Elpinqi Mërkuri – Duhet të kalojmë rendin e ditës...sill shkresën..

Z.Atird Hoxha – Nuk ke dëshirë të kuptosh..Të mbaroj fjalën për procedurë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – The, ishim në konferencën e kryetarëve..në cilën konferencë? Je kryetar grupi ?

Z.Atird Hoxha – Jam kryetar grupi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – S’kam nevojë të më mësosh. S’më ofendon dot, ti ofendon veten.

Kalojmë rendin e ditës, me propozimin e zotit Nika .

Z.Atird Hoxha – Nuk e bën dot me dhunë

Znj.Elpinqi Mërkuri – Po bën ti dhunë psikologjike kundrejt çdo këshilltari dhe administratës. S’mund të të lë të shprehesh kështu.

Z.Atird Hoxha – Morrët kohë të diskutonit, që thotë zoti Moçka , që erdhi një ditë para dhe nuk janë njohur. Ne kemi futur materiale dhe gjysëm ore para fillimit të mbledhjes, prandaj kjo s’qëndron. Për ngritjen e komisionit dhe zoti Moçka, është dakort parimisht. ...Pse e hidhni në votim , që ta rrëzoni me forcën e kartonit..Janë lekët e qytetarëve. Por, kjo gropë do të shtohet dhe, ky komision të ngrihet sa më shpejt për të penguar këtë hemoragji.

Z.Ervis Moçka – I drejtohem zotit Hoxha, të reflektojë për mënyrën se si i drejtohet dhe kryetares. Është totalisht politike. Zoti Nika, e kishte bërë gati që të ngrihej një komision që, të shqyrtojë vendimet gjyqësore. Pra është një projektvendim thjesht, për të bërë debat...Kemi dy përfaqësues në bordin mbikqyrës. Të vijjnë të na sqarojnë. Në objekt nuk keni dakortësinë tonë, në numër s’ka dakortësi. Aq mirë e dinin që nuk kalonte ky komision..Është i pavotueshëm, i parregullt juridikisht. 51% ministria..çfarë do shqyrtohet ? Thërrit në këshill përfaqësuesit e bordit.

Është sjellë një propozim dhe kaloje në votim me propozimin e zotit Nika.

Z.Gjergji Nika – Nëqoftëse, flasin zotërinjtë e bordit..., do të shohim faktet. Çfarë është apeluar? Mund të jetë vendim i përkohshëm? Do nxirrja dhe emrat e atyre që kanë marrë lekët. Ne do shohim dosjet konkrete, hapat konkretë. Ne, nëqoftëse, një e ka fituar me të drejtë , por nëqoftëse... Do monitorohet institucioni.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Propozimin e zotit Nika, për ta futur në rendin e ditës ? Votohet.

Pro – 12 vota

Kundër – 25 vota

Abstenim – 2 vota

Nuk kalon në rendin e ditës.

Kalojmë rendin e ditës. Votohet

Pro – 32vota

Kundër – 5 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 6/1, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes!

Fillojmë me shprehjen e ligjshmërisë , ardhur nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.(lexon shkresën) ku Vendimet e Këshillit të Bashkisë Nr 32-42, datë 30.04.2024, janë vlerësuar të ligjshëm.

Vijojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 30.04.2024.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 6/2, datë 29.05.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Viojmë me pikën 1 të rendit të ditës, me projektvendimin “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin prill 2024”

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 6/3, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin prill 2024”.

Votohet.

Pro- 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 6/4, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë me pikën 3 të rendit të ditës, me projektvendimin “ Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesës shtetërore të paprivatizuar “.

Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/5, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, më projektvendimin “ Mbi miratimin e vendqëndrimeve të autoveturave taksi në Bashkinë Vlorë dhe kriteret për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi “.

Një relacion nga administrata dhe më pas nga komisionet.

Z.Zambak Selmani – Projektvendimi kady pika shtimin dhe përmirësimin e vendparkimeve.

-Janë 135 vendqëndrime për taksi.

-Për (4+1) – 140 liçenca.

Disa nga kriteret e liçensimit;

-Për herë të parë , mjete duhet të jetë 10 vjeçar;

-Për riliçensim,15 vjeçar;

-Për kompanitë, minimalisht 5 vjet, me kilometrazh zero.

Z.Endri Hyseni – Ky projektvendim u diskutua në komisionin, do të thoja një saktësim, tek pika 2 e projektvendimit ..lexon..për kompanitë... 1 vit prodhimi.... ,pronë ose të huazuara, pra të shtohet termi “të huazuara”, kjo dhe sipas Udhëzimit të Ministrisë.

Znj.Eda Begaj – Mbi miratimin e vendqëndrimeve , s’kam asgjë për të shtuar. Përsa u përket kompanive, tu vihet një kushtqë të jenë elektrike, për një qytet të pastër.

Është material i kopsitur për të gjitha rrugët, por problem është për qytetarët që vuajnë për vendparkime. Mendoj që, duhet parë dhe investuar, dhe sygjerime për parkime. Është e vështirë sot të gjesh një vendparkim.

Znj.Alta Haluci – Jam dakort me këtë projektvendim, por do të theksoja për mungesën e një terminali, për vendqëndrimet e autobuzave dhe furgonave, taksi (8+1)...Nëqoftëse, do të ishte e mundur dhe për oraret në stacionet e autobuzave, të jenë elektrike, për tu njohur me oraret e lëvizjeve.

Z.Erëmal Arapi – Taksitë me punën që u bë , taksitë u futën nëpër lagje. E keni përcaktuar me ngjyrë të bardhë . E keni si simbolike...Pse, ka dhe ngjyra të tjera..Mund ta liberalizosh.

Z.Myzafer Elezi – Kam marrë pjesë në takimet me shoqatën e taksistëve. Është i dakortësuar me ta . Kërkesë e shoqatës së taksistëve, të vihen tabelat për qytetarët.

Bashkëpunimi me Policinë e shtetit..janë vendqëndrimet për taksistët që paguajnë taksat. Pas miratimit dhe shprehjes së ligjshmërisë nga prefekti, ti dërgohet një shkresë Policisë së shtetit. Detyrë prioritare Policia bashkiake.

Z.Illir Aliaj – Edhe tek Komisioni i transporteve kaloi ky projektvendim, u trajtuan këto problematika.

Duke qenë se, ky projektvednim është mbështetur në ligj dhe në rregullore, dakort dhe me zotin Endri, për shtesën e termit “të huazuara “, ta kalojmë në votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim me ndryshimin e propozuar nga zoti Hyseni ?

Kur të mësohet si të flasësh, do të jepet fjala.

Zoti Hoxha , je i pezulluar nga mbledhja (Largohen anëtarët Erëmal Arapi, Alta Haluci, Atird Hoxha,Klodian Xhyheri, Dikens Bushaj,Gjergji Nika, Eneida Vera,Myzafer Elezi, Eda Begaj, Arsen Belaj)

Atëherë, vijojmë mbledhjen. Është shumë fyese për këtë që këshilltarët të bëjnë veprime ordinere. Në radhë të parë respektin për qytetarëte Vlorës dhe jo të bëjmë shfaqje dhe akte të dhunshme...Nuk do mbrohen nga këshilli bashkiak.

Hedhim në votim , me propozimin e zotit Hyseni .

Votohet.

Pro – 26 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/6, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Viojmë me pikën 5 të rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave , në Bashkinë e Vlorës”. Nga administrata një relacion.

Znj.Aulona Veizi – Është një detyrim ligjor, bazuar në ligjin “Për vetqeverisjen vendore” dhe ligjit “Për Turizmin “...Është një plan veprimi, ka masa konkrete dhe më pas do delegohet në drejtorinë përkatëse.

Znj.Evis Allushi – Si kryetare e komisionit të turizmit, lidhur me këtë projektvendim, është një plan veprimi që është i shoqëruar dhe nga një studim i mirëfilltë., që prek zonat bregdetare por jo vetëm, lidhur me ndotjen akustike.

Ka plan masash për përmirësimin e situatës dhe bashkëpunimin e bashkisë me institucionet e tjera.

Ne si komision e kemi miratuar këtë plan veprimi dhe mbas miratimit në këshill, të bëhet sa më efikas, pasi jemi në sezonin turistik.

Në komision kemi diskutuar dhe problematika të tjera, si pyetje, kërkesa të cilat i kemi depozituar në lidhje me ecurinë e sezonit turistik, ku presim përgjigje nga administrata.

Për të patur sezon sa më të mirë dhe më të qetë , duhet bashkëpunim dhe me institucionet e tjera. Nëse është e mundur , pasi e theksova për të bërë një mbledhje jashtë radhe, për sezonin turistik.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E hedhim në votë.

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/7, datë 29.05.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, “Raport i monitorimit të zbatimit të buxhetit , për periudhën janar – prill 2024”. Një relacion nga drejtori i financës?

Z.Kozma Mali – Po paraqes një relacion në lidhje me raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar – prill 2024. Të ardhurta për periudhën 4 mujore , janë realizuar në masën 497 milion e .../reja , kundrejt planit vjetor që është 1miliard e....

Për këtë 4 mujor 26,3% është masa e realizimit. Ne si bashki, fonde të çelura nga Dega e Thesarit , nga të ardhurat e veta ..në masën 69,9% të përdorura

Nga granti i pakushtëzuar, në masën 82,2% të përdorura dhe, nga granti specifik në masën 70,2% të përdorura.

Përsa i përket performancës, mund të flasim drejtorët e tjerë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka ndonjë pyetje ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/8, datë 29.05.2024

Znj.Elpinijq Mërkuri - Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për anëtarësimin e Bashkisë Vlorë, në projektin CIVICRAZIA në Macro-Rajonin e Mesdheut”. Një relacion nga drejtori juridik për këtë projekt.

Z.Dorian Demiri – Ky projektvendim ka si qëllim anëtarësimin e Bashkisë Vlorë në Macro Rajonin e Mesdheut. Aktiviteti përfshin 4 shtylla ; Ekonomia blu, Ekonomia e gjelbër, të drejtat e njeriut ...

Znj.Elpinijq Mërkuri – Ka ndonjë pyetje ?

Znj.Elca Bezhani – Në lidhje me raportin e monitorimit ...Unë do ta shikoja me vend që të theksoja dhe njëherë para qytetarëve.

Znj.Elpinijq Mërkuri – E kaluam këtë pikë

Znj.Elca Bezhani – Ky është një material informues, me të ardhurat dhe shpenzimet . Është fillim viti dhe bashkia lëvront fonde. Ne në raport kemi parë shifrat nga Drejtoria e Tatim Taksave , Urbanistika , Juridike, ndërkohë mungonte analiza e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore , e cila nuk merret vetëm me rekrutimin e punonjësve. Por, a është bërë vlerësimi i punonjësve sipas kodit civil ?

Shifrat janë prezantuar , qoftë prokurimet, por do këmbëngul tek situata e taksës së grumbulluar nga toka bujqësore. Nuk patëm informacion. Të na jepet një listë me debitorët e qirasë së tokës bujqësore.

-Shqetësim i Ujësjetllës – Kanalizime..Për 4 mujorin e parë SH.A ka derdhur 7 milion për bashkinë . A është kjo tarifë e vjelë dhe e derdhur 100%? Pra, çfarë është 7.221 mijë ... Borxhi i Sh.A.Ujësjetllësit ndaj bashkisë..U tha që do bëhej një marrëveshje. U ngrit pretendim nga këshilltarët e opozitës , për vendimet gjyqësore... Kjo ndërmarrje drejtohet nga Bordi, Këshilli Mbikqyrës..Në rastet e pretenduara se, Bashkia Vlore është 43%..., do të ketë probleme në financën e Bashkisë Vlorë .

Të thirren drejtuesit e Bordit Mbikqyrës, në lidhje me përcaktimin e këtyre pagave.

-Dua një data base për kompensimin financiar , për ato që kanë fituar gjyqet.

-Kush e ka përfaqësuar ndërmarrjen në gjykatë dhe a ka pas apeline ?

-Të njihemi dhe me vendimet e ekspertëve të gjykatës.

-A janë apeluar ndonjë herë këto vendime dhe sa janë këto vendime ?

-Të thirren përfaqësuesit e Bordit.

Ne na interesojnë lekët e qytetarëve, Ujësjiellësi është agjent tatimor.

-Të krijohet një mekanizëm,në mënyrë që, lekët të derdhen në emër të Bashkisë Vlorë, mos të bllokohen.

Z.Ervis Moçka – Përgëzoj kryetaren e komisionit..U shty mbledhja , nuk u dakortësua. Ishim fare të paqartë. Nuk di çfarë do kërkonte ky komision i përhershëm, kur shumë mirë, kryetare e komisionit i sqaroi të gjitha , ku dhe zoti Nika, ka qenë anëtar komisioni. Komisioni ka ndjekur procedurat ligjore , kështu që gjithçka u kërkuanjë punë që fare mirë e ka bërë komisioni i financës. Përgëzime.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Meqenëse, ky ishte vazhdimi i pikës që sapo miratuam , tani mendoj të kalojmë për miratim projektvendimin . Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 6/8, datë 29.05.2024

Znj.Elpiniaq Mërkuri - Pika “Të ndryshme “. Kush e do fjalën ?

Z.Illir Aliaj – Herën e kaluar u ngrit shqetësimi nga zoti Çapoj, ku u kërkua informacion për sezonin turistik. Çfarë masash do marrë Bashkia Vlorë, në lidhje me turizmin. Ndërsa sot u kërkua nga ju , çfarë është bërë me problematikat .

U kërkua ndryshim i orarit të zhvillimit të mbledhjes nga opozita ose kush do flasë në fillim, administrata apo kryetari i komisionit...Por kjo denigroi , do parë mirë nga ana juridike. Unë mendoj që kjo procedurë të vazhdojë siç ishte.

Opozita ngre shqetësimin për mos mbledhjen e komisionit të arsimit dhe barazisë gjinore. Ne e dimë që komisionet nuk mund të mbledhen vetë, por sipas problematikave .

Tek pika , të ndryshme , dua të ngre shqetësimin e banorëve të Njësisë së Shushicës, të cilët kërkojnë në mënyrë urgjente, kalimin e lumit në kanal in vaditës. Të jetë në qendër të vëmendjes, të kthehet sa më shpejt.

Z.Gëzim Çapoj – E ndiej detyrim që vlerat e këshillit , ti çojmë në vendin e duhur. Jemi në ball të sezonit turistik. Të gjenden problematikat, tu jepet zgjidhje. Për çdo problematikë të këshilltarit, administrata , duhet të kthejë përgjigje. Ne të vendosim autoritetin tonë.

Mendimi im, vazhdon të jetë, kush do flasë nga drejtoria e turizmit, e cila ka shumë problematika. Mardhënia me Policinë e shtetit ...Problemi i energjisë, Ujësjellësit ..Në administratë i kanë të evidentuara problematikat , por mendoj që, ka indiferencë. Administrata duhet ti kontrollojë . Duhet të kërkohet llogari për të bërë punën.

Një program i shkurtër, të evidentohen problematikat.

Z.Edison Kapaj – Shqetësimi im në lidhje me Ujësjellësin , me fshatrat Oshëtimë – Kërkovë – Panaja , që nuk furnizohen me ujë të pijshëm. Këto ditë kam takuar dhe punonjës të Ujësjellësit dhe e shoh shumë të largët zgjidhjen e këtij problemi.

Këkrojt të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi.

Znj.Irena Toshkallari – Unë e vlerësoj diskutimin Tuaj, zoti Çapoj. E vë si parantezë që, shpesh diskutoni për paaftësinë e administratës.

-Për prezencën e drejtorëve, janë të pranishëm.

-Për turizmin, është ngritur një grup multistruktural , nga shumë drejtorë për masat e marra për secilin sektor.

Të jetë informacion shterues dhe për qytetarët.

-Policia bashkiake , në lidhje me kontrollet dhe masat nga policia bashkiake. E kemi si punë relacioni, për çdo drejtori.

Z.Gëzim Çapoj – Një informacion i shkurtër .

Z.Daut Zëraj – Me shkrim.

Znj.Irena Toshkallari – Si e doni materialin, kthim përgjigje ?

Z.Gëzim Çapoj – Në lidhje me të gjitha problematikat e ngritura , të na vijë një informacion, me e-mail që ta lexojmë .

Znj.Elca Bezhani – E mbështes mendimin e zotit Çapoj.

Z.Gëzim Çapoj – Ne këshilltarët, s’bëjmë opozitë me administratën. Ne jemi për të ndfihmuar . Këshilli me firmën e kryetares së këshillit bashkiak ka dërguar shkresë zyrtare dhe nuk marrim përgjigje. Nuk çohet asgjë deri në fund. Ne marrim në dorë projektvendime shumë të rëndësishme të administratës.

Kur kërkojmë përgjigje, le të na kthehet nga administrata përgjigje . Kam detyrimin tim moral, shkoj dhe trokas pa hezitim tek administrata e bashkisë, por përgjigje duhet tu kthehet gjithë këshilltarëve .

Znj.Irena Toshkallari – Detyrimi im është të theksoj për prezencën e drejtorëve, për tu dhënë përgjigje.

Znj.Elca Bezhani – Shënime duhet të mbajnë dhe drejtorët në lidhje me kërkesat tona. Duam të gjejmë zgjidhje për problematikat e ngritura .

-Nuk shikoj të bëhen vlerësime të performancës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore .

Znj.Irena Toshkallari – Vlerësimi i performancës, është detyrim ligjor. Do të keni relacion.

Znj.Elca Bezhani – Nga gjithë analizat e drejtorive , mungonte analiza e DBNJ, pasi s’merret vetëm me punësime.

Znj.Irena Toshkallari – Do t’ju kthehet përgjigje.

Z.Daut Zëraj – Prezenca e drejtorëve , është të kthejnë përgjigje në moment dhe është tjetër gjë kur depozitohen me kërkesë që tu kthehet përgjigje.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Faleminderit zonja Nënkryetare..Në asnjë mënyrë që të quhen të paaftë, nuk e vëmë në diskutim..Përsa u përket diskutimeve, kërkesave që ne ngrejmë, jemi këtu në emër të qytetarëve.

Znj.Edlira Kapllanaj – Nga Policia e Vlorës kërkoj ...Në katin e II, tek “Conad”, është bërë “vatër “infeksioneshMerrni masa, sa më parë të vihet patrullë, derisa të ndërjegjësohen

Drejtori i Policisë Bashkiake – Nuk është detyra jonë për pronë private, por do t’ia kaloj

Policisë së shtetit.

Z.Novrus Rrokaj – Në drejtim të ndarjes së mbetjeve inerte .Ka nevojë për një sensibilizim qytetar .Të shoqërohet me masa. Ka orendi të hedhura gjithandej. Të merren masa nga bashkia.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse nuk ka gjë tjetër, faleminderit !